VENDIM
Nr. 113, datë 9.7.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E RREGULLORES MBI PROCEDURAT E NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK TË AKTEVE TË MIRATUARA NGA ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 16 dhe 18, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar; nenit 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 78/7 prot., datë 30.6.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Ligjore "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë",

konstatoi se:

- Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, të realizuar në kohë dhe efektiv, ndërmjet organeve publike qendrore dhe vendore dhe palëve të interesuara, në procesin e vendimmarrjes së projektakteve si: projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik.

- Ligji nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, parashikon në nenin 18 se ERE miraton rregulloren për konsultimet publike, ku për aq sa është e mundur merr në konsideratë procedurat dhe afatet e legjislacionit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik, ku, ndër të tjera, parashikohen kushtet dhe procedurat, paraqitja e kërkesës formale dhe shpallja publike e informacionit.

- Rregullorja e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, ka një sërë parashikimesh ligjore që lidhen me përmbushjen e detyrimit të ERE-s për konsultimin publik të akteve rregullatore të cilat miraton për kompetencë.

- Një detyrim të kësaj natyre, ERE e ka zbatuar në mënyrë rigoroze përgjatë gjithë veprimtarisë së saj, jo vetëm si detyrim i parashikuar në ligjin sipërcituar, por mbi të gjitha si një aspekt shumë i rëndësishëm i ushtrimit të kompetencave funksionale e detyrave të sanksionuara në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar.

- Në mbështetje të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, si dhe ligjit nr. 7/2017, "Mbi nxitjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", ERE, që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtyre ligjeve, ka miratuar rreth 90 akte nënligjore të llojit rregullore, metodologji, marrëveshje tip etj., e riparë me kërkesë të palëve të interesit këto akte në procedura që kalojnë përmes të njëjtave faza që kalon vetë miratimi i aktit, në rreth 40 praktika të tjera.

- Rregullorja e propozuar për miratim sjell detajim të procedurave dhe afateve për përmbushjen e detyrimit të organeve publike për konsultim publik.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti